

FJALA E DEPUTETES JORIDA TABAKU

E HËNË 17 TETOR 2022

E nderuar zonja Ambasadore,

E nderuar zonja Ministre,

Zonja Dhuka,

Zoti Balla,

Të nderuar kolegë,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Përfaqësues të institucioneve të reformës në drejtësi,

Pak ditë më parë u prezantua strategjia e zgjerimit dhe raporti për Shqipërinë, që çdo vit na tregon se ku jemi. Në fakt, askush nuk mbetet gjithmonë i kënaqur nga situata e paraqitur atje. Gjithmonë, si qeveria, ashtu edhe opozita, ndoshta lexojnë atë që u pëlqen, megjithëse është e shkruar e zezë mbi të bardhë situata, progresi, edhe mosprogresi në disa raste, në dokumente, si në strategjinë e zgjerimit, ashtu edhe në raportin e vendit.

Ky është raporti i parë që dorëzohet ndërsa Europa është e përfshirë nga një luftë e padëshiruar, por e detyruar, një ngjarje e veçantë që ka ndryshuar për mirë deri tani, në fakt, qasjen e BE-së ndaj parimeve të saj, dhe në veçanti ndaj rajonit tonë. Duket se Europa po e gjen forcën së brendshmi për ta kaluar këtë krizë, këtë luftë.

Por megjithëse shumëçka duket se ka ndryshuar, edhe nga disa vende skeptike ndaj Shqipërisë, shumë pak ka ndryshuar nga Shqipëria në raport me detyrimet karshi vetes sonë dhe, pa dyshim, BE-së. Një proces nuk mund të shkojë para në qoftë se të gjitha institucionet e vendit nuk kanë frymën, energjinë, vizionin, ritmin dhe drejtimin që duhet të ndjekin.

Tashmë që Konferenca e Parë është çelur, besoj se është më e qartë për këtë maxhorancë dhe për qeverinë se ky është një proces merite, që ka së paku dy aktorë brenda dhe duhet patjetër të ketë brenda dy aktorë. Parlamenti sigurisht që është njëri nga ata.

Në këto kushte, kur Europa është shumë e hapur për të mikëpritur Shqipërinë, është e pandershme ndaj nesh, por edhe ndaj qytetarëve, që të mos bëjmë maksimumin dhe të mos jemi aty ku duhet.

Me shqetësim konstatova se vlerësimi për grupin e parë dhe cluster-in e parë është i njëjtë me atë të një viti më parë; i njëjtë edhe me atë të dy vjetëve më parë.

Kam kërkuar nga kjo sallë dhe jashtë kësaj salle, që qeveria shqiptare të punonte pavarësisht një date, duke e ditur që do të arrinim këtu. Unë mendoj se atëherë kur çdo gjë duhet ta kishim vendosur në funksion të këtij procesi, nuk e bëmë.

Për mua është shqetësues fakti, ashtu siç shprehet edhe në raport, që qeveria shqiptare nuk e ka treguar ende vullnetin e plotë politik, ndoshta vullneti është atje, por vullneti tregohet me hapa konkretë, me masa dhe reforma konkrete.

Korrupsioni mbetet një fushë me shqetësim serioz. Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare të zyrtarëve të nivelit të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e mosndëshkimit.

Raporti thekson se duhet vullnet më i madh politik dhe vë në dukje se si gjyqësori po përpiqet të intimidohet në njëfarë mënyre; korrupsioni i nivelit të lartë dhe politik duhet të trajtohet në mënyra më vendimtare, pasi vazhdojnë shenja të konflikteve të forta të interesave publike me ato private. Duhet një vullnet politik më i madh, një strukturim më i fortë, gjithashtu resurset e duhura dhe aftësitë për të shkuar te niveli i mjaftueshmërisë.

Ky Këshill Kombëtar këtë duhet të diskutojë, se cilat janë nevojat e institucioneve të reja të luftës ndaj korrupsionit, të cilat ne, si Kuvend, do duhet t'i vendosim menjëherë në dispozicion.

Javë më parë një anketë e OECD-së renditi se një nga shkaqet madhore për largimin e qytetarëve nga rajoni ishte korrupsioni. Nuk ka shqiptar, brenda dhe jashtë kësaj salle, që nuk dakordësohet se ky është shkaku themelor për largimin nga vendi të qytetarëve tanë. Fatkeqësisht, sot ky korrupsion, nuk është më korrupsion banakësh, që luftohet me shërbime online, për të cilat kam dyshimet e mia për aksesueshmërinë, por është korrupsion politik, korrupsion me ligje, korrupsion që ka kapur nivelet më të larta të partive politike dhe të parlamentit. Kjo është një sëmundje që ka nevojë për ndërhyrje urgjente.

Krimi i organizuar vazhdon të mbetet një problem për Shqipërinë, i cili eksportohet nga rajoni në vendet e BE-së, deri në Amerikën Latine, dhe po depërton në jetën ekonomike e financiare të vendit.

Dua të përshëndes marrëveshjen me Europol-in, ashtu siç shprehet drejt dhe në progresraport, një kërkesë për Konferencën e Parë Ndërqeveritare, por kjo nuk është e mjaftueshme.

Fatkeqësisht, përpos problematikës së korrupsionit dhe krimit të organizuar, ka edhe dy probleme të tjera, për të cilat kemi vite që flasim: problemi i pasaportave të arta, por njëkohësisht dhe ligji për amnistinë fiskale.

“Shqipëria duhet të përmbahet nga zhvillimi i një skeme të nënshtetësisë së investitorëve, pasi do të përbënte rrezik për sa i përket sigurisë, pastrimit të parave, evazionit fiskal”, por, nga ana tjetër, raporti shpreh se miratimi i një amnistie tatimore dhe penale kundër këshillave të BE-së, mund të rrezikojë përparimin në këtë fushë.

Në lidhje me sistemin gjyqësor, megjithëse njihen arritjet e realizuara si rezultat dhe në kuadër të reformës në drejtësi, përsëri kemi procedura të gjata dhe një numër të madh të çështjeve të mbetura, të cilat vazhdojnë të ndikojnë negativisht në efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Unë jam ende duke pritur që të shoh rezultate gjithnjë e më konkrete, pasi e kam të qartë se pandëshkueshmëria është një nga arsyt kryesore pse sot ka mungesë shprese tek të rinjtë dhe qytetarët. Drejtësia sot ka detyrimin që të shkëputet politikisht nga pushteti ekzekutiv, sikundër ka dhe detyrën të dëshmojë pavarësinë e saj e, mbi të gjitha, guximin për të prekur aty ku duhet, dhe aty ku pushteti është më i fortë.

Nuk dua të bëj moralizëm, por dua të përmend një shembull konkret. Më vjen keq që, ndërsa lexoja emrat e propozuar për disa nga institucionet më të larta të drejtësisë, vura re emrat e personave që kanë shkruar reformën në drejtësi. Imagjiloni pak sikur parlamenti të mblidhet, të miratojë ligje ose të ndërtojë institucione, ku të emërohen po vetë deputetët, pra sikur qëllimi dhe synimi përfundimtar i gjithë kësaj reforme të ketë qenë vendosja në krye të çdo institucioni i atyre që kanë shkruar reformën!

A mos votuam një reformë në drejtësi për të shembur korporatizmin e disa emrave dhe për ta bërë atë korporatizëm të disa emrave të tjerë? Unë nuk besoj se ka qenë ky qëllimi i parlamentit.

Për fatin e keq, sot kemi në institucionin e Kryeministrit një kullë qendrore kontrolli, ku kemi një sërë agjencish, të cilat i kam denoncuar herë pas here, që kanë cenuar të drejtën e informacionit, koordinimin e fondeve, por njëkohësisht edhe aksesin që kanë mediet tek informacioni publik. Askush nuk i ka harruar “internimet” e gazetarëve apo “rehabilitimet” e tyre që të kujtojnë kohë të

padëshirueshme, apo edhe “Kështjellën” e Kafkës”, për ata që kanë qejf ta citojnë Kafkën. Të gjitha këto janë shqetësime, të cilat gjejnë reflektim edhe në raport.

Ndërsa flasim, para pak javësh në Konferencën e Kryetarëve u diskutua njëkohësisht edhe dekreti i Presidentit për ligjin antishpifje, që, sipas gjykimit tim, nuk duhet të ketë vend për t’u diskutuar në parlamentin shqiptar. Ironikisht, sa më shumë përqendrohet pushteti aq më pak ligje kalojnë për ta përafuar Shqipërinë me BE-në, vetëm 9 ligje gjatë vitit të fundit.

Unë besoj se është detyra jonë, e këtij parlamenti, e qeverisë shqiptare dhe e kujt do që sot është dhe merret me politikë që të trajtojmë edhe çështjet e ekonomisë. Besoj se raporti e shpreh qartë që nuk promovohen konkurrenca dhe meritokracia dhe se ka mundësi më të kufizuara në treg, por fatkeqësisht kjo po ndikon në largimin masiv të shqiptarëve. Shqipëria gjithnjë e më shumë është vlerësuar për fqinjësinë e mirë dhe për ravijëzimin e politikës së jashtme me partnerët strategjikë.

Më lejoni t’ju them sot këtu pa asnjë kompleks, zonja Ministre Xhaçka, se e përshëndes dhe mbështes plotësisht qëndrimin e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si dhe rezolutat e propozuara. Ne mund të ndahemi për shumë gjëra me njëri-tjetrin, ne e lexojmë ndryshe raportin, siç mund ta lexojë ndryshe edhe qeveria, por besoj se për çështjet e sigurisë kombëtare, por edhe për çështje të bashkërendimit të politikës së jashtme me partnerët strategjikë ne duhet të jemi dhe jemi bashkë.

Pa dyshim, unë do të kisha dashur që qeveria shqiptare të bënte më shumë përpjekje për Kosovën në Këshillin e Sigurimit, akoma nuk i kam parë ato, por ndoshta situata gjeostrategjike është e tillë dhe fokusin e ka lufta ndaj Ukrainës, por besoj se kemi ende kohë gjatë këtij mandati për t’i diskutuar këto çështje.

Unë besoj, ashtu siç e thotë edhe Çurçilli: “Ata që nuk mësojnë nga historia janë të dënuar që ta përsërisin atë”, se ne gjatë këtyre 8 vjetëve kemi bërë shumë gabime, në fakt i ka bërë qeveria, por gjatë 30 vjetëve të gjithë bashkë kemi faj për gjendjen ku ndodhet sot Shqipëria. Në mënyrë që të mos i përsërisim më gabimet, kam këmbëngulur në mënyrë të herë pas herë që procesi screening të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës.

Ne sot jemi kthyer në një banor thuajse permanent të paradhomës. Shqipëria është kandidatja e përhershme për anëtarësim dhe besoj se nxitimi për të ecur përpara është një nxitim i ligjshëm, jo vetëm yni, por në radhë të parë i shqiptarëve. Ky proces duhet të jetë i atyre qytetarëve, të cilët nuk

kanë përse të përdoren si baseni i sondazheve të politikave të gabuara, por si përfitues të një procesi për të cilin ne duhet të punojmë.

Unë mendoj se i takon edhe zonjës ambasadore që është këtu, megjithëse sapo e ka filluar këtë mandat, rishtare, si mbajtëse e këtij portofoli, që të na shtyjë ne, parlamentin dhe qeverinë, kur nuk e kemi dëshirën apo ritmin e duhur, për reforma. Unë sot jam në këtë pozicion dhe nesër mund të mos jem, sepse askush nuk është i përhershëm në politikë, të gjithë jemi të përkohshëm, por kjo besoj se kjo nuk ka lidhje me individët, por me institucionet.

Unë besoj se qeveria shqiptare duhet ta respektojë institucionin e parlamentit dhe të opozitës dhe të dyja këto institucione duhet të përfshihen në këtë proces, sepse ky nuk mund të jetë proces vetëm i njëjës palë. Për këto arsye, duke shpresuar që është hera e fundit, po e përsëris edhe një herë kërkesën time edhe ndaj ministres së re, kryenegociatores, për një raportim më shpeshtë në parlament në mënyrë që të rritet intensiteti i komunikimit dhe i raportimit me parlamentin, sepse ndoshta edhe ne mund të dimë diçka më shumë, mund të japim një mendim apo të përfshihemi më shumë në këtë proces.

Ne duhet të heqim dorë nga heshtja si mjet komunikimi, sepse do të ishte e udhës dhe e dobishme për të dyja institucionet tona, për parlamentin, për atë që ne përfaqësojmë këtu, por njëkohësisht edhe për qeverinë që të kemi një komunikim strategjik për ta kthyer këtë në një proces të thjeshtë për qytetarët dhe për përfitimet që ata do të kenë. Ndërkohë, shqiptarët duhet ta kuptojnë se Bashkimi Europian ndër të tjera është edhe një mundësi e artë për të kryer biznes, për t'u rritur dhe për të zgjeruar horizontin dhe mundësitë. Shqiptarët duhet të kuptojnë se arsimit, diplomat, tregu, punësimi do të jenë mundësi reale, ashtu si dhe ky proces do të ketë pengesa e rezistencë, por na takon ne që ta bëjmë atë transparent, që rezistenca për ndryshim të vijë vetëm nga frika e transformimit dhe të mos jetë aftësia për t'u rritur dhe për t'u zgjeruar.

Për këto arsye e kemi të gjithë për detyrë që ta ndërtojmë Europën këtu, jo me sondazhe, propagandë dhe videoklipe dhe as me fjalë apo fjalime, por me vepra, akte dhe vullnet politik, të cilin deri më sot nuk e kemi treguar, por që duhet ta tregojmë.

Unë jam shumë e bindur që procesi i integritetit është një shans i jashtëzakonshëm, të cilin qeveria shqiptare duhet ta përdorë për "brain gain", një mundësi e jashtëzakonshme që pasurinë e madhe, të cilën e kemi humbur gjatë këtyre viteve ta rifitojmë dhe ta rikthejmë këtu dhe të ndërtojmë një shoqëri ku meritokracia, mobiliteti social dhe konkurrenca të jenë bazat. Ne duhet të luftojmë që nismat ligjore,

çdo nismë ligjore, të jetë në përputhje me frymën dhe normat e standardeve të BE-së. Për këto arsye ka ardhur koha që të gjithë të punojmë, ne dhe institucionet tona dhe ta përdorim këtë raport si një plan pune, duke i ndarë bashkë shqetësimet dhe t'i kërkojmë ndihmë dhe mbështetje parlamentit jo vetëm për të miratuar ligje, por t'i përfshijmë ato që në krye të herës në këtë proces.

Duke shpresuar që nuk u zgjata në fjalën time më shumë sesa duhet (zoti Balla është duke qeshur se është i sigurt që jam zgjatur më shumë sesa duhet), por meqenëse do të kemi dy përfaqësues të qeverisë që do të flasin, besoj se më lejohej.